



Republika e Kosovës

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE)

**RREGULLORE PËR KUSHTET E
PËRGJITHSHME TË OPERIMIT TË FONDIT TË
KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË**

PËRMBAJTJA

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	4
Neni 1 - Pasqyra e kushteve të përgjithshme të operimit.....	4
Neni 2 - Përkufizime	5
Neni 3 - Qasja programore	7
II. INSTRUMENTET PËR DHËNIEN E MBËSHTETJES FINANCIARE DHE STIMUJVE	7
Neni 4 - Instrumentet për dhënie e mbështetjes financiare dhe stimujve	7
III. KRITERET DHE MASAT PËR PËRCAKTIMIN E PALËVE TË KUALIFIKUARA PËR MBËSHTETJE FINANCIARE	7
Neni 5 - Palët e kualifikuara.....	7
Neni 6 - Investimet e kualifikuara (të pranueshme).....	8
IV. METODA DHE PROCEDURAT PËR DHËNIEN E MBËSHTETJES FINANCIARE	9
Neni 7 - Lloji i procedurave për dhënie e mbështetjes financiare	9
Neni 8 - Aplikimi për përfitimin e mbështetjes financiare	9
Neni 9 - Procedura e vendimmarrjes.....	9
Neni 10 - Kthimi në gjendjen e mëparshme	10
Neni 11 -Kufizimet në dhënie e mbështetjes financiare	10
Neni 12 - Vendimi për dhënie mbështetjes financiare.....	10
Neni 13 – Disbursimi i mbështetjes financiare	11
Neni 14 - Konteksti i Thirrjes Publike	11
Neni 15 - Përmbajtja e thirrjes publike	11
Neni 16 - Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve.....	12
Neni 17 - Hapja e Aplikacioneve për mbështetje financiare.....	13
Neni 18 - Plotësimi i aplikimit për marrjen e mbështetjes financiare	13
Neni 19 - Ndryshimi i aplikimit për marrjen e mbështetjes financiare	13
Neni 20 - Procedura e shqyrtimit të aplikacioneve	14
V. MARRËVESHJET PËR SHËRBIME TË ENERGJISË.....	14
Neni 21 - Parimet e marrëveshjes për shërbime të energjisë	14
Neni 22 - Fushëveprimi i shërbimeve të FKEE-së	15
Neni 23 - Hapat e zakonshëm të hartimit të projektit të Eficiencës së Energjisë që ka të bëjë me MSHE-në	15
Neni 24 - Kompensimi i FKEE-së nga pranuesi i shërbimeve të FKEE-së.....	16
VI. DHËNIA E FONDEVE TË PAKTHYESHME	17
Neni 26 - Fondet e pakthyeshme	17
Neni 27 – Grantet	17
Neni 28 - Pranueshmëria për marrjen e granteve shtesë	18
VII. KUFIZIMET NË DHËNIEN E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR SHKAK TË RREGULLAVE PËR NDIHMËN SHTETËRORE.....	19
Neni 29 – Mbështetja financiare si ndihma shtetërore ose ndihma sipas rregullit “de minimis”	19

VIII. QËLLIMI I SYNUAR I MBËSHTETJES FINANCIARE	19
Neni 30 - Caktimi i fondeve për mbështetje financiare.....	19
Neni 31 - Monitorimi i zbatimit të marrëveshjeve	19
Neni 32 - Informimi	20
Neni 33 - Raportimi për mbështetjen financiare	20
Neni 34 - Përdorimi i synuar i mbështetjes financiare	21
Neni 35 - Efektet e përmirësimit të efijencës së energjisë të investimeve të personave fizikë	21
IX. NDRYSHIMET E MARRËVESHJEVE PËR DHËNIEN E MBËSHTETJE FINANCIARE.....	22
Neni 36 - Ndryshimi i marrëveshjes për dhënie e mbështetjes financiare	22
X. RRJEDHOJAT E MOSPËRMBUSHJES SË DETYRIMEVE	22
Neni 37 - Shkelja e marrëveshjes për dhënie e mbështetjes financiare	22
XI. ZBATIMI I PROCEDURAVE T PROCURIMIT PUBLIK.....	23
Neni 38 - Konteksti i Tenderit Publik	23
XII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE.....	23
Neni 39 - Rregullat e KFEE-së për dhënie e ndihmave shtetërore dhe ndihmave “de minimis” ...	23
Neni 40 - Manuali i operacioneve i KFEE-së.....	23
Neni 41 - Hyrja në fuqi.....	24

Në përputhje me nën paragrafët 4.1 dhe 4.9 të paragrafit 4 të nenit 42 të Ligjit nr. 06/L-079 për Efiçencë të Energjisë (Gazeta Zyrtare nr. 2018/21 e Republikës së Kosovës), Bordi i Drejtorëve i Fondit të Kosovës për Efiçencë të Energjisë nxjerrë:

RREGULLORE PËR KUSHTET E PËRGJITHSHME TË OPERIMIT TË FONDIT TË KOSOVËS PËR EFIÇENCË TË ENERGISË

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 - Pasqyra e kushteve të përgjithshme të operimit

1. Kushtet e përgjithshme të operimit të Fondit të Kosovës për Efiçencë të Energjisë (në tekstin e mëtejshëm: “Kushtet e përgjithshme të operimit”), për promovimin e investimeve në efiçencën e energjisë (referuar po ashtu si “projekt i efiçencës së energjisë”) në gjithë Kosovën duke ndihmuar në zhvillimin e ndihmës së qëndrueshme financiare për zbatimin e masave të efiçencës së energjisë në disa sektorë, do të përcaktojë:

- 1.1 Kriteret dhe masat bazë për përcaktimin e subjekteve të kualifikuara për mbështetje financiare dhe stimuj nga FKEE,
- 1.2 Procedurat për përzgjedhjen e subjekteve të kualifikuara për financim të FKEE-së në kuadrin e:
 - 1.2.1 komponentit qarkullues (në formën e marrëveshjeve për shërbime të energjisë), dhe
 - 1.2.2 komponentit jo qarkullues (në formën e fondeve të pakthyeshme - granteve ose ndonjë instrumenti tjetër në pajtim me Ligjin nr. 06/L-079 për Efiçencë të Energjisë dhe rregulloret të brendshme të FKEE-së (si në nënparagrafët 1.2.1 dhe 1.2.2 të referuar tani e tutje si “mbështetje financiare”),
- 1.3 Metodën dhe procedurat për dhënien e mbështetjes financiare sipas nënparagrafit 1.2 të këtij neni,
- 1.4 Kushtet për alokimin e llojeve individuale të mbështetjes financiare dhe stimujve nga fondet e caktuara për FKEE-në ose asetet e tjera të dedikuara, sipas rregullave në fuqi,
- 1.5 Fushëveprimin e mbështetjes financiare që mund të pranohet nga një përfitues i caktuar që ka të drejtë përfitimi, si dhe kufizimet e tjera në dhënien e mbështetjes financiare,
- 1.6 Shfrytëzimin e dedikuar të mbështetjes financiare të dhënë, dhe
- 1.7 Mënyrën e zgjidhjes së të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella të FKEE-së dhe të pranuesit të mbështetjes financiare (këtu e tutje referuar si “përfituesi”) dhe pasojat në rast të shkeljes të këtyre detyrimeve.

2. Kushtet e përgjithshme të operimit duhet të konsiderohen si pjesë përbërëse e thirrjes publike.

3. Kushtet e përgjithshme të operimit duhet të përdoren normalisht edhe në rastin kur FKEE-ja jep fonde si ndërmjetës financiar nën një emër të huaj ose për një llogari të huaj, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga rregulloret në fuqi, aktet e themelimit ose marrëveshja për realizimin dhënies (grantimit) mjeteve financiare të huaja.

Neni 2 - Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1 **Përfituesi** është marrësi i fundit - marrësi i mbështetjes financiare të dhënë nga FKEE.
 - 1.2 **Bordi i Drejtorëve** - organi kryesor i FKEE, përgjegjës për mbikëqyrjen e përgjithshme të FKEE në përputhje me dispozitat e Ligjit për Eficiencën e Energjisë.
 - 1.3 **Kapital** - burimet financiare të FKEE, duke përfshirë çdo shumë në depozitat bankare të FKEE për mbështetjen e investimeve në eficiencë të energjisë, si dhe shumat e burimeve financiare tashmë të investuara që do t'i paguhen Fondit nga përfituesit e saj.
 - 1.4 **Investim i pranueshëm** - një investim i cili plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe politikës së investimit, siç përcaktohet në Ligjin për Eficiencën e Energjisë dhe rregulloret e brendshme të FKEE.
 - 1.5 **Auditimi i Energjisë** - është procedurë sistematike e realizuar nga një auditor i energjisë, qëllimi i së cilës është siguri i informatave të domosdoshme lidhur me profilin e konsumit të energjisë nga një ndërtesë apo grup ndërtesash, një veprimtari, instalim industrial apo komercial, apo një shërbim privat apo publik, me të cilin identifikohen dhe kuantifikohen mundësitë e kursimit kosto-efektiv të energjisë dhe raportohen rezultatet.
 - 1.6 **Energjia bazë** – është konsumi mesatar i energjisë dhe kostot e energjisë për një periudhë adekuate prej së paku dy (2) viteve para zbatimit të investimit, siç llogaritet përmes Auditimit të Energjisë. Energjia bazë normalizohet duke përdorur variabla që ndikojnë në konsumin e energjisë, siç janë niveli i komfortit termal, ndriçimi, ventilimi dhe nivelet e tjera të komfortit siç përcaktohet me rregullat dhe rregulloret në fuqi, kushtet mesatare klimatike në lokacion dhe variabla të tjerë relevantë. Normalizimi i energjisë bazë do të bëhet sipas praktikave të mira inxhinierike dhe në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare për menaxhimin e energjisë dhe auditimin e energjisë.
 - 1.7 **Projekti për Eficiencën e Energjisë** - është një projekt investimi që përbëhet nga një ose më shumë masa për të përmirësuar efikasitetin e energjisë që do të implementohet me qëllim të kursimit të energjisë.
 - 1.8 **Palët e kualifikuara** janë persona juridikë dhe fizikë që kanë të drejtë të marrin mbështetje financiare për investime të eficiencës së energjisë nga KEEF.
 - 1.9 **Marrëveshje për Shërbime Energjetike (MSHE)**– janë marrëveshje ligjore të nënshkruara në mes FKEE dhe një subjekti publik që i mundësojnë FKEE të ofrojë shërbime të plota përfshirë financimin për zbatimin e projekteve të eficiencës së energjisë dhe t'i rikthejë investimet nga subjekti publik, bazuar në kursimet e parashikuara të kostos së energjisë kundrejt energjisë bazë, para investimit.
 - 1.10 **Kursimi i energjisë** – sasia e energjisë së kursyer, e përcaktuar duke matur dhe ose parashikuar konsumin para dhe pas realizimit të një apo më shumë masave për ngritje të eficiencës së energjisë, në kontekst të normalizimit të kushteve të jashtme që ndikojnë në konsumin e energjisë.
 - 1.11 **Konsumi fundor i energjisë** – do të thotë tërë energjia e furnizuar për industri, transport, amvisëri, shërbime dhe bujqësi. Kjo nuk përfshin energjinë e liferuar në sektorin e prodhimit të energjisë dhe te vetë industrinë energjetike.

- 1.12 **Mbështetje Financiare** - është çdo formë ndihme financiare e dhënë nga FKEE tek përfituesi që përmirëson fizibilitetin ekonomik dhe qëndrueshmërinë financiare të projektit të efijencës së energjisë.
- 1.13 **Fondet** – janë të gjitha burimet financiare që i ndahen FKEE nga Qeveria e Kosovës, Institucionet Financiare Ndërkombëtare apo donatorët tjerë, me qëllim të përkrahjes së investimeve në efijencës të energjisë, duke siguruar njëkohësisht qëndrueshmërinë afatgjatë në përputhje me Ligjin për Efijencën e Energjisë.
- 1.14 **Marrëveshje Ndërkombëtare e Financimit** – një marrëveshje, pa marrë parasysh formën ligjore të saj, e nënshkruara mes një donatori apo Institucioni Financiar Ndërkombëtar dhe Republikës së Kosovës, që specifikon përdorimin e fondeve të ofruara nga donatori, llojet e investimeve të pranueshme dhe kushtet dhe konditat tjera me fondet e donatorëve
- 1.15 **Fondi i Kosovës për Efijencë të Energjisë (FKEE ose Fondi)** – një entitet i pavarur, dhe i qëndrueshëm siç përcaktohet në Nenet 24 dhe 25 të Ligjit për Efijencën e Energjisë.
- 1.16 **Plani Afatmesëm i Punës** - nënkupton Planin e Zhvillimit të Biznesit të FKEE të referuar në paragrafin 4.4 të Nenit 42 të Ligjit për Efijencën e Energjisë. Plani do të përfaqësojë një plan të vazhdueshëm për minimum tre (3) vjetët e ardhshëm që do të azhurnohet rregullisht në baza vjetore.
- 1.17 **Plani Kombëtar i Veprimit për Efijencë të Energjisë (PKVEE)** përcakton dhe përshkruan veprimet për arritjen e objektivave të politikës shtetërore në fushën e efijencës së energjisë, duke përfshirë skemën e detyrimeve të efijencës së energjisë, masat e politikave të efijencës së energjisë, kursimet e energjisë të arritura ose të parashikuara për t'u arritur në nivel të furnizimit, transmetimit, shpërndarjes dhe konsumit final të energjisë, me qëllim që të përmbushen caqet kombëtare të efijencës së energjisë.
- 1.18 **Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (në tekstin e mëtejshëm NVM)** – janë ndërmarrje që punësojnë përkatësisht deri dyzet e nëntë (49) dhe dyqind e dyzet e nëntë (249) persona, sipas Ligjit për Investimet e Huaja.
- 1.19 **Kursimet e parapara të kostos së energjisë** – kursimi i energjisë dhe kostove që pritet të realizohet nga investimi në Efijencë të energjisë, i kalkuluar nën të njëjtat kushte që janë shfrytëzuar për të përcaktuar energjinë bazë.
- 1.20 **Entitete publike** – janë institucionet qeveritare të nivelit qendror dhe ato lokale (komunat) që mund të pranojnë përkrahje për investime nga FKEE, në bazë të Marrëveshjeve për Shërbime Energjetike apo të përftojnë nga instrumentet tjera financiare relevante të themeluara nga FKEE.
- 1.21 **Konsumatori familjar** – është çdo person apo grup personash që ka në pronësi dhe ose posedim prona të destinuar për banim, apo që kanë të drejtë të pranojnë përkrahje nga FKEE për investime në efijencë të energjisë.
- 1.22 **Qarkullues** – është investimi i serishëm i kapitalit të kthyer në Fond nga përftuesit që kanë realizuar investimet në efijencë të energjisë në bazë të financimit nga Fondi.

Neni 3 - Qasja programore

Fondi do të veprojë në baza programore tre (3) vjeçare dhe vjetore. Aktivitetet e FKEE do të jenë në përputhje me PKVEE, programet e zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe veprime të tjera të caktuara FKEE-së sipas dispozitave të Ligjit për Efiçencën e Energjisë (paragrafi 4 i Nenit 33).

II. INSTRUMENTET PËR DHËNIEN E MBËSHTETJES FINANCIARE DHE STIMUJVE

Neni 4 - Instrumentet për dhënie e mbështetjes financiare dhe stimujve

1. Për dhënie e mbështetjes financiare, në kuptimin e zbatimit të aktiviteteve të tij, FKEE-ja mund të përdorë këto instrumente:

- 1.1 Marrëveshjet për shërbimet e energjisë (MSHE)
- 1.2 Fondet e pakthyeshme (grantet),
- 1.3 Instrumentet e tjera financiare që mund të zhvillohen nga FKEE, me miratimin paraprak të Bordit të Drejtorëve të FKEE, si dhe pëlqimin paraprak të ministrive përgjegjëse për energji dhe financa (nëse kërkohet).

III. KRITERET DHE MASAT PËR PËRCAKTIMIN E PALËVE TË KUALIFIKUARA PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 5 - Palët e kualifikuara

1. Mbështetja financiare për investime, masat dhe aktivitetet e tjera mund të përfitohen nga:

- 1.1 Institucionet publike – institucione administrative në nivelin qendror dhe lokal (komunal),
- 1.2 Operatorët ekonomik (kompanitë) dhe personat tjerë juridikë me seli në Republikën e Kosovës, me përjashtim të filialeve jashtë vendit, të cilat kryejnë një aktivitet fitimprurës,
- 1.3 Filialet e kompanive të huaja të cilat realizojnë aktivitete fitimprurëse dhe që janë regjistruar në regjistrin e bizneseve të Republikës së Kosovës,
- 1.4 Sipërmarrësit privat ose personat fizik, të cilat realizojnë në mënyrë të pavarur aktivitete si profesion ose që janë të regjistruar për kryerjen e një aktiviteti në pajtim me dispozitat e një ligji të veçantë, me seli ose banim të përhershëm në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: “sipërmarrësit privat”).
- 1.5 Personat fizik me banim të përhershëm në Republikën e Kosovës.

2. Personat që nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga mbështetja financiare janë personat juridik dhe fizik:

- 2.1 Të cilët kanë ndonjë detyrim të pashlyer e të maturuar ndaj FKEE-së,
- 2.2 Të cilët kanë ndonjë tatim të pashlyer ose detyrime të tjera ndaj Republikës së Kosovës,

2.3 Të cilët janë në procedurën e shpërbërjes së detyruar, falimentimit ose likuidimit, dhe që kanë një llogari të bllokuar me të cilën nuk mund të kryejnë transaksione.

3. Për një thirrje individuale publike ose çfarëdo procedure tjetër për dhënien e mbështetjes financiare FKEE-ja duhet të përcaktojë palët e kualifikuara që mund të përfitojnë. Duke marrë parasysh qëllimin dhe synimet e mbështetjes financiare në pajtim me Planin Afatmesëm të Punës të FKEE-së, pa marrë parasysh kërkesat e Paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, edhe subjekte tjera të kualifikuara mund të përcaktohen nga FKEE-ja si subjekte që nuk mund të përfitojnë nga mbështetja financiare.

Neni 6 - Investimet e kualifikuara (të pranueshme)

1. Mbështetja financiare për investime në projektet e efijencës së energjisë (duke përfshirë energjinë e ripërtitshme, kur është e aplikueshme) mund të përfitohen nga subjektet e kualifikuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje në rast të investimit të kualifikuar në përputhje me nenin 3 (1.40) të LEE-së dhe në pajtim me këtë rregullore. Ndonëse kriteret përkatëse të pranueshmërisë do të paraqiten me hollësi në thirrjen publike, kriteret e përgjithshme të politikës së investimeve përfshijnë këta sektorë dhe masa të efijencës së energjisë (në kllapa):

- 1.1 Industria - e kufizuar në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, sipas legjislacionit në Kosovë (kursimi i energjisë në ndërtesat e administratës dhe në proceset industriale: zëvendësimi i motorëve, pompave, sistemeve joefikase të rregullimit, kompresorëve joeficientë, etj.).
- 1.2 Transporti (mbështetje për komunat dhe/ose ofruesit e shërbimeve publike, ndërmarrjet dhe personat e tjerë juridikë; për investime në automjetet elektrike dhe autobusët me efijencë të energjisë në transportin publik),
- 1.3 Bujqësia (vadtje me efijencë të energjisë dhe sistemet e përpunimit/tharjes së drithërave, për sistemet e rikuperimit të nxehtësisë (nga mbetjet), kogjenerimi me efijencë të lartë (në rastet kur është e mundur nga pikëpamja teknike dhe e realizueshme nga ana ekonomike),
- 1.4 Tregtia dhe shërbimet publike (ndërtesat e qeverisjes qendrore dhe komunale: administrative, qendrat e edukimit, kopshtet, bibliotekat, qendrat e kujdesit shëndetësor, etj., fillimisht për rinovimin e ndërtesave ekzistuese në standard pasiv dhe më pas, për ndërtesat e sapondërtuara që konsumojnë pak energji, janë pasive dhe/ose “me nevojë pothuajse zero për energji”),
- 1.5 Sektori banesor (për investimet në kursimin e energjisë dhe rritjen e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtitshme në lidhje me ndërtesat banesore (shtëpitë dhe blloqet banesore), sistemet efikase të ngrohjes / ventilimit dhe kondicionimit të ajrit, kalimi nga karburantet fosile te burimet e ripërtitshme të energjisë, investime në sistemet me efijencë energjetike në konsumimin e ujit, sistemet e kanalizimeve, sistemet e vogla të trajtimit të ujërave të zeza, për investime në automjetet elektrike).

2. Politika e përgjithshme për investimet dhe kriteret përkatëse duhet të pasqyrohen në Planin Afatmesëm të Punës të FKEE-së.

3. Në pajtim me Planin Kombëtar të Veprimit për Efijencë të Energjisë të Kosovës dhe programet e përfshira në të, për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe veprimet e tjera që i janë caktuar FKEE-së për zbatim, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Efijencë të Energjisë, FKEE-ja duhet të bëjë çdo gjë për të cilën ka kompetencë për të promovuar efijencën e energjisë në sektorët që përmenden në nënparagrafët 1.1-1.5 të këtij neni, në

pajtim e parimet e një qasjeje novatore, duke gjurmuar standardet më të fundit për zbatimin e programeve dhe projekteve në nivelin ndërkombëtar.

4. Programet e avancuara dhe projektet novatore që mbështeten në përdorimin e teknologjive më të fundit dhe standardeve teknike të planifikuara për zbatim me ndihmën e FKEE-së do të pranojnë mbështetje më të madhe financiare krahasuar më standardet dhe normat mesatare që përdoren në Kosovë. Sidoqoftë, kur mbështeten programe të tilla të avancuara dhe projekte novatore, FKEE do të marrë parasysh fondet e disponueshme të donatorëve dhe do të sigurojë që qëndrueshmëria e komponentit qarkullues të FKEE-së nuk rrezikohet.

IV. METODA DHE PROCEDURAT PËR DHËNIEN E MBËSHTETJES FINANCIARE

Neni 7 - Lloji i procedurave për dhënie e mbështetjes financiare

1. FKEE-ja lejon lidhjen e marrëveshjeve për shërbime të energjisë (MSHE) dhe jep fonde të pakthyeshme-grante, në bazë të një thirrjeje publike ose tenderi publik, në pajtim me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës dhe këtë rregullore.

2. Në rastet ku FKEE-ja operon në pajtim me rregullat dhe kushtet e marrëveshjeve ndërkombëtare të financimit të cilat kanë epërsi ndaj legjislacionit të Republikës së Kosovës, mbështetur në dispozitat e nenit 33(1) të Ligjit për Efiçencë të Energjisë, këto rregulla mund të ndikojnë në thirrjen publike duke përfshirë kërkesa shtesë dhe/ose kërkesa specifike për donatorët/IFN-të.

3. Mbështetja financiare për projektet e efiçencës së energjisë të mbështetura nga FKEE-së jepen në pajtim me procedurën e përcaktuar nga Ligji për Efiçencë të Energjisë të Republikës së Kosovës, ligjeve tjera të aplikueshme dhe rregulloreve të tjera të FKEE-së që janë në fuqi.

4. Fondet për bashkëfinancimin e projekteve për rritjen e vetëdijes ose programeve për promovimin publik të aktiviteteve të FKEE-së (p.sh. projektet jo investuese) jepen përmes një tenderi publik të hapur nga FKEE me miratimin paraprak të Bordit të Drejtorëve.

Neni 8 - Aplikimi për përfitimin e mbështetjes financiare

1. Procedura për dhënie e ndihmës financiare në bazë të thirrjes publike individuale ose ndonjë akti tjetër publik të FKEE-së fillon me një kërkesë me shkrim për të përfituar mbështetje financiare të bërë nga pala e kualifikuar (përfituesi i ardhshëm).

2. Kërkesa që përmendet në paragrafit e mësipërm parashtrohet me anë të një formulari të veçantë, që përcaktohet sipas secilës thirrjeje publike ose ndonjë akti tjetër të FKEE-së ose dokumentacioni për aplikim.

Neni 9 - Procedura e vendimmarrjes

1. Dispozitat e “Rregullores për operacionet administrative të FKEE-së” zbatohen për vendimin lidhur me aplikimin për mbështetje financiare.

2. Hapat praktikë në parashtrimin e kërkesës, të përmendur në paragrafin e mësipërm të këtij neni, nga dorëzimi i aplikacionit deri te marrja e vendimit zyrtar, duhet të përshkruhen me hollësi në “Udhëzuesin për operacionet teknike” të FKEE-së – “Manuali i Operimit” i

FKEE-së, që miratohet nga Bordi i Drejtorëve të FKEE-së, si dhe në Rregulloret e Brendshme të FKEE-së.

Neni 10 - Kthimi në gjendjen e mëparshme

1. Në rast të mosrespektimit të afatit për dorëzimin e aplikacionit për dhënien e mbështetjes financiare, nuk do të lejohet kthimi në gjendjen e mëparshme.
2. Në rast të vonesës së akteve të tjera procedurale në procedurën e dhënies së mbështetjes financiare, kthimi në gjendjen e mëparshme lejohet vetëm nëse, deri në momentin e parashtrimit të propozimit për rikthim në gjendjen e mëparshme, periudha për dorëzimin e aplikacioneve për marrjen e mbështetjes financiare nuk ka përfunduar ende.

Neni 11 -Kufizimet në dhënien e mbështetjes financiare

1. Krahas kufizimeve të përcaktuara me rregulloret që rregullojnë fushën e ndihmës shtetërore, në rast të lidhjes së një marrëveshjeje për shërbime të energjisë (MSHE) FKEE-ja duhet të marrë parasysh edhe këto kufizime në procedurën për dhënien e mbështetjes financiare subjekteve të kualifikuara:

- 1.1 Shuma më e madhe për mbështetjen e projekteve individuale të eficiencës së energjisë përmes MSHE-së nuk mund të tejkalojë 500,000 EUR,
- 1.2 Përfituesi duhet të demonstrojë aftësinë për kryerjen e detyrimeve gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies kontraktuale,
- 1.3 Afati për kthimin sipas MSHE-së nuk mund të kalojë periudhën ekonomike të investimit, për të cilin jepet mbështetja financiare. Në të njëjtën kohë, periudha e rikthimit nuk duhet të tejkalojë 15 vite.

2. Pavarësisht nga dispozitat e Paragrafit 1.1 të këtij neni, në raste të jashtëzakonshme dhe për projekte tërheqëse, shuma mund të tejkalojë me një vendim paraprak të Bordit të Drejtorëve. Në çdo rast, kufiri më i ulët dhe më i lartë përcaktohet nga thirrja publike.

3. Shuma e përgjithshme e ekspozimit financiar të FKEE-së ndaj një përfituesi të vetëm si komuna, entiteti publik, biznesi ose ekonomia familjare, përcaktohet me thirrje publike.

4. Kufizime të tjera të mundshme përcaktohen me anë të thirrjes publike ose ndonjë procedure tjetër të dhënies së mbështetjes financiare.

Neni 12 - Vendimi për dhënien mbështetjes financiare

1. Në rastin e vendimmarrjes shumëhapëshe (p.sh. në rastin e MSHE-së), FKEE-ja mund të nxjerrë një vendim të përkohshëm dhe të plotfuqishëm për dhënien e mbështetjes financiare. Procedurat dhe termat e tjerë të aplikueshëm të nxjerrjes së vendimeve të përkohshme dhe të plotfuqishme duhet të përcaktohen në thirrjen publike dhe përshkruhen më tej në "Manualin e operacioneve" të FKEE-së.

2. Në rastin e procesit të vendimmarrjes njëhapëshe, FKEE-ja detyrohet të nxjerrë një vendim që është final.

3. Mjetet juridike kundër vendimit dhe akteve të tjera individuale të nxjerra nga FKEE-ja gjatë procedurës për dhënie e mbështetjes financiare përcaktohen nga “Rregullorja për operacionet administrative” të FKEE-së.

Neni 13 – Disbursimi i mbështetjes financiare

1. FKEE-ja lidh ose një marrëveshje për shërbimet e energjisë (MSHE) ose një marrëveshje tjetër të përshtatshme për dhënie mbështetjes financiare në pajtim me vendimin e zbatueshëm, përmes të cilit është dhënë e drejta për mbështetje financiare.

2. Në rastin e MSHE-së, disbursimi i mbështetjes financiare do të menaxhohet nga FKEE-ja, e cila do të ndërmarrë hapa që kontraktuesit e saj për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të eficientës së energjisë të rimburohen drejtpërsëdrejti, në përputhje me procedurat e brendshme ose procedurat e dakorduara me institucionet financuese ndërkombëtare/ donatorët në rast të IFA.

3. Në të gjitha rastet e tjera të mbështetjes financiare me përjashtim të MSHE-së që ka të bëjë me sektorin publik, fondet mund ti paguhen përfituesit duke u mbështetur në një marrëveshje të vlefshme dhe të lidhur në kohën e duhur, siç përcaktohet në paragrafin e parë të këtij neni dhe përmbushjen e të gjitha kushteve të tjera të përcaktuara në thirrjen publike, tenderin publik, ose ndonjë akt tjetër të FKEE-së ose në dokumentacionin për aplikim dhe vendimin për dhënie e së drejtës për mbështetje financiare.

4. Një parakusht tjetër për dhënie e mbështetjes financiare (në sasi të plotë ose pjesë-pjesë, të përcaktuar me dinamikën e pagesës në marrëveshje) është që të gjitha shërbimet e përmendura në marrëveshje të jenë ofruar nga përfituesi dhe që të gjitha faturat të jenë parashtruar në formularët e kërkuar.

Neni 14 - Konteksti i Thirrjes Publike

1. Thirrja publike do të jetë metoda kryesore e përdorur nga FKEE për marrjen e "aplikacioneve për të përfituar mbështetje financiare" nga përfituesit e ardhshëm, të cilët kanë për qëllim zbatimin e projekteve të eficientës së energjisë, përmes një MSHE.

2. Aplikimet e pranuar për të përfituar mbështetje financiare që përfshijnë projekt propozime për eficientë të energjisë do të trajtohen në bazë të parimit **“kush vjen e pari, shërbehet i pari”** detajet e të cilave do të përshkruhen më hollësisht në Manualin e Operativave të FKEE-së.

Neni 15 - Përmbajtja e thirrjes publike

1. Thirrja publike ose dokumentacioni për aplikim për përfitim të mbështetjes financiare, duhet të përcaktojë të paktën:

1.1 Lënda e thirrjes publike,

1.2 Palët e kualifikuara (të pranueshme),

1.3 Qëllimi i investimit ose masat për të cilat palët e kualifikuara mund të përfitojnë ose mund të mos përfitojnë mbështetje financiare;

- 1.4 Vëllimin total të burimeve të disponueshme financiare për dhënien e mbështetjes financiare,
- 1.5 Kufizimet e shumës më të vogël dhe më të lartë të mbështetjes financiare me anë të një projekt-propozimi dhe një përfituesi,
- 1.6 Kriteria të përgjithshme të pranueshmërisë dhe kushtet për përfitimin e mbështetjes financiare,
- 1.7 Kriteret specifike të pranueshmërisë në thirrjen publike (të përgjithshme, masa të efikasitetit të energjisë, të tjera),
- 1.8 Kriteret mjedisore, financiare dhe kriteret e tjera për dhënien e mbështetjes financiare,
- 1.9 Parimet mbi të cilat do të trajtohet kërkesa/aplikimi,
- 1.10 Kriteret e pranueshmërisë së projektit (teknike dhe/ose ekonomike) dhe afatet e mundshme për arritjen e rezultateve,
- 1.11 Procedura për shqyrtimin e aplikacionit dhe struktura komisionit për shqyrtimin e aplikacioneve të pranuar,
- 1.12 Formularët e aplikimit që duhen plotësuar dhe lista e dokumenteve të tjera që duhet t'i bashkëngjiten formularit,
- 1.13 Dokumentet tjera (draft kontratat dhe formularët e tjerë) si informata të hershme për parashtruesin e kërkesës,
- 1.14 Udhëzimet për dorëzimin e aplikimit për përfitim të mbështetjes financiare sipas thirrjes publike.

2. Në rastin e MSHE-së, thirrja publike ose dokumentacioni i aplikimit duhet të përcaktojnë edhe:

- 2.1 Masat ekonomiko-financiare për vlerësimin e aplikacionit për marrjen e mbështetjes financiare ose për vlerësimin e pozitës financiare të palës së kualifikuar (të pranueshme);
- 2.2 Periudhën më të gjatë të kthimit të mbështetjes financiare të ofruar nga FKEE ose kushtet dhe procedura e kthimit të financimit,
- 2.3 Kufizime të tjera të mundshme të shumës së financimit të projektit individual, duke përfshirë kufizimet që rrjedhin nga rregulloret e vlefshme për kufizimet ose lejimin e ndihmave shtetërore.

Neni 16 - Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve

1. Komisioni i ekspertëve, në trajtën e komisionit për shqyrtimin e aplikacioneve për shqyrtimin e propozimeve të pranuar si përgjigje ndaj thirrjes publike të shpallur nga FKEE-ja, do të emërohet nga drejtori menaxhues i FKEE-së me një vendim me shkrim.

2. Komisioni për Shqyrtimin e Aplikacioneve do të përbëhet nga të paktën tre (3) ekspertë që kanë ekspertizë në financa, në fushën e inxhinierisë dhe zbatimit praktik të projekteve të efikasitetit të energjisë (dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë, aty ku është e përshtatshme), të cilët duhet të jenë anëtarë personeli të FKEE-së, me përjashtim të rastit të parashikuar në paragrafin 5 të këtij neni.

3. Në varësi të programit lëndor që është duke zbatuar aktualisht nga FKEE-ja, Komisioni për Shqyrtimin e Aplikacioneve do të jetë një komision i përhershëm, d.m.th. me të njëjtët anëtarë për të gjitha projektet në kuadrin e një programi të caktuar.

4. Nëse anëtari i Komisionit për Shqyrtimin e Aplikacioneve heq dorë ose pengohet, për çfarëdo shkak, nga ushtrimi i detyrës, drejtori menaxhues do ta zëvendësojë atë menjëherë, por më së largu brenda 10 ditëve pune.

5. Nëse FKEE-ja nuk ka ekspertizë të mjaftueshme në një fushë të caktuar profesionale të thirrjes publike, FKEE-ja mund të kërkojë asistencë nga ekspertë të jashtëm të nivelit të lartë (nënkontraktim). Megjithatë, kryetari i komisioni për Shqyrtimin e Aplikacioneve është gjithmonë anëtar i rregull i personelit të FKEE-së.

6. Komisioni për Shqyrtimin e Aplikacioneve shqyrton secilin propozim ose sipas radhës që është paraqitur (d.m.th. sipas parimit “kush vjen i pari, shërbehet i pari”) në rastin e thirrjes publike. Propozimet e pranuar vlerësohen duke u bazuar në kriteret e përcaktuara të pranueshmërisë të cilat duhet të përshkruhet me hollësi të mjaftueshme në thirrjen publike.

Neni 17 - Hapja e Aplikacioneve për mbështetje financiare

1. Vetëm aplikacionet për marrje të mbështetjes financiare, të cilat janë dorëzuar brenda afatit, janë të plota, të rregullta e të shënuara, do të hapen sipas radhës së dorëzimit të tyre.

2. Komisioni për Shqyrtimin e Aplikacioneve mban shënime për hapjen e aplikacioneve për marrje të mbështetjes financiare.

Neni 18 - Plotësimi i aplikimit për marrjen e mbështetjes financiare

1. Në rast se aplikacioni për marrjen e mbështetjes financiare nuk është i kompletuar, FKEE-ja do të kërkojë nga parashtruesi i aplikacionit që më së largu brenda 30 ditësh të sigurojë informacionet që mungojnë ose kërkesat për qartësime, në pajtim me Rregulloren për Operacionet Administrative të FKEE-së.

2. Nëse parashtruesi i aplikacionit i korrigjon mangësitë e përmendura në paragrafin paraprak brenda afatit të dhënë, aplikimi për marrjen e mbështetjes financiare do të konsiderohet se është parashtruar atëherë kur është dorëzuar aplikacioni për marrjen e mbështetjes financiare, dhe mangësitë janë korrigjuar. Në rastin e zbatimit të parimit të kërkesave, “kush vjen e pari, shërbehet i pari” dhe të përpunimit të këtyre kërkesave nga FKEE-ja, do të ruhet numri unik vijues që i është caktuar projektit (kërkesës).

3. Nëse aplikuesi dështon në korrigjimin e mangësive brenda afatit të caktuar në aplikacionin e FKEE-së për marrje të mbështetjes financiare, sipas paragrafit të parë të këtij neni, kërkesa e tij për marrjen e mbështetjes financiare duhet të refuzohet me vendim të FKEE-së.

Neni 19 - Ndryshimi i aplikimit për marrjen e mbështetjes financiare

1. Ndryshimi i aplikacionit për marrjen e mbështetjes financiare, e cila është parashtruar nga parashtruesi i aplikacionit, mbetet e pranueshme deri në fund të procedurës, por, për sa i takon renditjes së aplikimeve të plotësuara për marrjen e mbështetjes financiare, do të konsiderohet se kërkesa e ndryshuar për marrjen e mbështetjes financiare është dorëzuar përsëri.

2. Përjashtimet nga paragrafi i parë i këtij neni janë të mundshme në rastet kur FKEE-ja, në thirrjen e vet publike, përcakton afate të ndryshme dhe ndoshta edhe pasoja (aty ku është e aplikueshme), afate këto brenda të cilave mund të ndryshohet aplikacioni për marrjen e mbështetjes financiare.

Neni 20 - Procedura e shqyrtimit të aplikacioneve

1. Komisioni për Shqyrtimin e Aplikacioneve kryen inspektimin profesional të aplikacioneve të plota për marrjen e mbështetjes financiare dhe i vlerëson ato në bazë të kushteve dhe masave që parashikohen në thirrjen publike. Komisioni mban një regjistër të përditësuar për kryerjen e inspektimit profesional të kërkesave të plota për marrjen e mbështetjes financiare dhe për vlerësimin e tyre.

2. Anëtari i komisionit për Shqyrtimin e Aplikacioneve, i cili e gjendet në konflikt interesi që do të çonte në shkeljen e "Kodit të etikës" të FKEE-së, duhet të heqë dorë nga puna e Komisionit për Shqyrtimin e Aplikacioneve dhe, sipas rrethanave, ta informojë menjëherë drejtorin menaxhues. Ky anëtar përjashtohet nga procedura e vlerësimit të këtyre aplikacioneve.

3. Përveç kësaj, Komisioni për Shqyrtimin e Aplikacioneve do të bëjë një vizitë në terren në vendin ku do të implementohet projektit. Mbi këtë bazë dhe në bazë të inspektimit nga paragrafi 1 i këtij neni, Komisioni për Shqyrtimin e Aplikacioneve do të përgatisë Raportin e Inicimit të Projektit për secilin projekt, së bashku me rekomandimet drejtuar Drejtorit Menaxhues për të dhënë pranimin e përkohshëm të projektit për ato projekte që plotësojnë kriteret e caktuara, në bazë të të cilit do të nënshkruhet Marrëveshja për Inicimin e Projektit me përfituesit e ardhshëm.

4. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes për Inicimin e Projektit, Drejtori Menaxhues do të emërojë një menaxher projekti për çdo projekt të miratuar përkohësisht. Përgjegjësia e tij / saj do të përfshijë menaxhimin e projektit përkatës deri në përfundimin e tij të suksesshëm dhe pranimin teknik përfundimtar pas komisionimit. Gjatë kësaj periudhe, Komisioni për Shqyrtimin e Aplikacioneve do të jetë në dispozicion të Menaxherit të Projektit në rast nevojë dhe / ose një konsultim i tillë kërkohet nga ai / ajo.

V. MARRËVESHJET PËR SHËRBIME TË ENERGJISË

Neni 21 - Parimet e marrëveshjes për shërbime të energjisë

1. Marrëveshja për shërbime të energjisë (MSHE) duhet të jetë instrumenti kryesor i FKEE-së për zbatimin e investimeve për efikasitet të energjisë në institucionet publike në kuadrin e komponentit qarkullues.

2. Marrëveshja për shërbime të energjisë nënshkruhet në mes të FKEE-së dhe një institucioni publik, çka i mundëson FKEE-së t'i investojë fondet e veta në një projekt të efikasitetit të energjisë dhe të rikuperojë investimet e veta nga institucioni publik, duke u mbështetur në kursimet e parashikuara nga kostot e energjisë.

Neni 22 - Fushëveprimi i shërbimeve të FKEE-së

1. Në emër të përfituesit, FKEE-ja do të organizojë dhe zbatojë përmes nën-kontraktimit këto shërbime:

- 1.1 Shërbimet për përgatitjen e Auditimeve të energjisë, projektimin dhe mbikëqyrjen e punëve dhe autorizimin(komisionimin);
- 1.2 Furnizimin me mallra dhe punë (ndërtimore);
- 1.3 Monitorimin dhe verifikimin pas zbatimit të projektit.

2. Të gjitha punët përgatitore, ato të zbatimit dhe aktivitetet pas zbatimit duhet të menaxhohen nga personeli i brendshëm i FKEE-së. Për secilin projekt, menaxheri i projektit (gjithashtu e përfshirë në paragrafin 4 të nenit 20 të kësaj rregulloreje) përcaktohet nga FKEE-ja, dhe do të ketë përgjegjësi për të menaxhuar dhe koordinuar të gjitha aktivitetet nga “Marrëveshja e nënshkruar e nisjes së projektit” deri te autorizimi i projektit dhe monitorimi e vlerësimi pas zbatimit të tij (p.sh. deri në pranimin teknik përfundimtar).

3. Marrëveshja për nisjen e projektit (gjithashtu e përfshirë në paragrafin 3 të nenit 20 të kësaj rregulloreje) nënshkruhet në mes të FKEE-së dhe përfituesit të shërbimeve të MSHE-së pas pranimit të përkohshëm të projektit për financim nga FKEE-ja. Të gjitha hollësitë e tjera përshkruhen në “Manualin e operacioneve” të FKEE-së.

4. KEEF rezervon të drejtën për të kombinuar disa forma të shërbimeve sipas nën paragrafëve të mësipërm 1.1 deri 1.4 të këtij neni si dhe për të kombinuar disa projekte individuale në kontrata të përbashkëta me kontraktorët me qëllim arritjen e shkallës së ekonomive dhe optimizimin e shpenzimeve administrative të menaxhimit të projektit.

Neni 23 - Hapat e zakonshëm të hartimit të projektit të Efiçencës së Energjisë që ka të bëjë me MSHE-në

1. Cikli i zhvillimit të projektit që ka të bëjë me MSHE-në përbëhet nga këta hapa kryesorë:

- 1.1 Identifikimi i projektit,
- 1.2 Parashtrimi i kërkesës në FKEE për zbatimin e projektit (marrjen e stimujve financiar),
- 1.3 Shqyrtimi i projektit dhe pranimi i përkohshëm nga Komisioni për Shqyrtimin e Aplikacioneve të FKEE-së,
- 1.4 Realizimi i auditimit të energjisë,
- 1.5 Projektimi(dizajnimi) i projektit,
- 1.6 Miratimi i Projektit final nga Drejtori Menaxhues i FKEE bazuar në rekomandimet Menaxherit të Projektit të FKEE dhe arritjen e Marrëveshjes Ligjore për zbatimin e projektit,
- 1.7 Zbatimi i projektit nga FKEE-ja dhe mbikëqyrja,
- 1.8 Autorizimi(komisionimi)/testimi në përfundim– pranimi i përkohshëm,
- 1.9 Monitorimi pas zbatimit – periudha e përgjegjësisë për defekte - pranimi përfundimtar.

2. Të gjitha hapat zhvillimorë të ciklit të projektit që kanë të bëjnë me MSHE-në përshkruhen me hollësi në “Manualin e operacioneve” të FKEE-së.

3. Projektet duhet të identifikohen dhe emërohen nga parashtruesit e kërkesave të cilët i përgjigjen thirrjes publike të shpallur nga FKEE-ja siç është përcaktuar me nenet 14-15 të kësaj rregulloreje.

Neni 24 - Kompensimi i FKEE-së nga pranuesi i shërbimeve të FKEE-së

1. Sipas nenit 39 të Ligjit për Eficiencë të Energjisë, FKEE-ja ka të drejtë ta tarifojë pranuesin për shërbimet e veta, në pajtim me nenin 21(1) të kësaj rregulloreje. Këtu përfshihen:

- 1.1 Tarifat për kompensimin e kostove të FKEE-së për asistencë teknike (d.m.th. auditimi i energjisë, projektimi, mbikëqyrja, autorizimi, monitorimi pas implementimit etj.);
- 1.2 Kthimi i kostove të investimit në projektin e eficiencës së energjisë dhe kostove të financimit;
- 1.3 Tarifimi i arsyeshëm për shpenzimet operative të FKEE-së – kompensimi për organizimin dhe menaxhimin e prokurimit, koordinimit dhe administrimit.

2. Për kostot e veta, FKEE-ja kompensohet përmes MSHE-së, e cila duhet të nënshkruhet midis FKEE-së dhe përfaqësuesit të autorizuar të pranuesit, ku institucioni i pranuesit duhet të dëshmojë nënshkrimin (p.sh. shkolla, spitali, kopshti etj.) që dëshmojnë nënshkrimin.

3. Procedurat e hollësishme që kanë të bëjnë me përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të FKEE-së, të cilat kanë të bëjnë me MSHE-të, jepen me hollësi në “Manualin e operacioneve” të FKEE-së.

4. FKEE do të ofrojë instrumente financiare në kushte të mjaftueshme stimuluese dhe konkurruese me praktikat ndërkombëtare për përfituesit që të marrin pjesë dhe të gjenerojnë kërkesa për shërbimet e FKEE-së.

5. Miratimi i kushteve të financimit të projekteve është kompetencë e Bordit të Drejtorëve të FKEE-së dhe do të miratohet si pjesë e thirrjes publike individuale.

Neni 25

Përmbajtja e marrëveshjes për shërbime të energjisë

1. Me anë të marrëveshjes për shërbime të energjisë (MSHE) duhet të përcaktohen të paktën:

- 1.1 Palët në MSHE (FKEE-ja dhe pranuesi),
- 1.2 Lënda e MSHE-së,
- 1.3 Përshkrimi i projektit për eficiencë të energjisë:
 - 1.3.1 Modalitetet parimore të zbatimit,
 - 1.3.2 Objekti ku realizohet projekti për eficiencë të energjisë dhe të dhënat kontrolluese të konsumit të energjisë,

- 1.3.3 Masat e efijencës së energjisë, të cilat duhet të ndërmerren në kuadrin e projektit të efijencës së energjisë,
 - 1.3.4 Metodologjia dhe llogaritja e kursimeve të parashikuara nga energjia (nga kostot e energjisë),
 - 1.3.5 Skema e kompensimit të investimeve për FKEE-në dhe kalendari i ndërtimit /instalimit,
 - 1.3.6 Zbatimi, mbikëqyrja dhe autorizimi i shërbimeve,
 - 1.3.7 monitorimi pas implementimit (pranueshmëria teknike),
 - 1.3.8 Shqyrtimi mjedisor.
- 1.4 Financimi:
- 1.4.1 Skema dhe mekanizmi i kompensimit të investimeve,
 - 1.4.2 Shumën e mbështetjes financiare,
 - 1.4.3 Termat dhe forma e kthimit të pagesës.
- 1.5 Pezullimi ose zgjatja e zbatimit të projektit të efijencës së energjisë,
- 1.6 Të drejtat dhe detyrimet e palëve,
- 1.7 Ndërprerja e marrëveshjes,
- 1.8 Shkeljet nga palët, mjetet juridike.

VI. DHËNIA E FONDEVE TË PAKTHYESHME

Neni 26 - Fondet e pakthyeshme

1. FKEE-ja mund të japë fonde të pakthyeshme për investime, duke përfshirë subvencionimin e normës së interesit ose kostove, të ndërlidhura me kreditë e palëve të treta ndaj përfituesve që kanë të drejtë të përfitojnë nga FKEE-ja me anë të një thirrjeje publike ose tenderi publik, sipas dispozitave të kapitullit IV dhe kushteve të përgjithshme të operimit.

Neni 27 – Grantet

1. Si instrument financiar joqarkullues, FKEE-ja mund t'u japë burime financiare të pakthyeshme (grantet) ose pjesërisht mjete financiare të pakthyeshme nën një marrëveshje MSHE përfituesve të vet, me kusht që këta përfitues dhe projektet e tyre që kanë të bëjnë me efijencën e energjisë të përmbushin kriteret e përcaktuara nga FKEE-ja.

2. Burimet e disponueshme financiare për grante përfaqësojnë një pjesë të vogël në kapitalin punues të FKEE-së në buxhetin vjetor të FKEE-së të miratuar nga Bordi i Drejtorëve. Zakonisht, nuk duhet të tejkalojë 30% të kapitalit të miratuar të FKEE-së në vitin përkatës. Kjo përqindje mund të tejkalohet në rrethana të veçanta për "dritare speciale" me vendim paraprak të Bordit të Drejtorëve të FKEE-së.

3. FKEE-ja mund të alokojë burime grantesh në buxhetin e vet vjetor vetëm nga burimet e jashtme të mobilizuara të dhëna sipas së njëjtës bazë të pakthyeshme (d.m.th. grant). FKEE-ja nuk do të merr kredi në llogari të vet dhe ti përdor ato për t'u dhënë përfituesve të vet fonde të pakthyeshme.

4. Objektivi specifik i dhënies së granteve është të mbështesë zhvillimin e tregut të efijencës së energjisë në fazat fillestare, me qëllim rritjen dhe sigurimin e një niveli të kënaqshëm të kërkesës nga përdoruesit për shërbimet e FKEE.

Neni 28 - Pranueshmëria për marrjen e granteve shtesë

1. Përfituesit mund të pranojnë grante shtesë në këto raste:

- 1.1 Si subvencione për përkrahjen e nxitjes së teknologjive më novatore të efijencës së energjisë (EE) dhe/ose teknologjive të burimeve të ripërtrishme të energjisë (BRE), tregtimi i të cilave përndryshe do të ishte i pamundur pa këtë ndërhyrje. Kjo mund të jetë e zbatueshme vetëm nëse ka fonde të disponueshme të donatorëve për këtë qëllim dhe FKEE nuk rrezikon qëndrueshmërinë e komponentit qarkullues;
- 1.2 Për të përkrahur projektet pilot me potencial të konsiderueshëm përsëritjeje në Kosovë;
- 1.3 Për të përkrahur projektet e EE-së dhe/ose BRE-ve në rastet ku nivelet e komfortit janë konsiderueshëm më poshtë sesa niveli standard, ku raporti midis “kursimeve reale nga energjia (kostot e energjisë)” dhe “të dhënave të konsumit bazë” nuk është realist;
- 1.4 Në komunat e vogla dhe/ose të varfra, sipas standardeve të Kosovës, të cilat nuk do të mund të përballonin zbatimin e projekteve të EE-së dhe/ose BRE-ve sipas skemës së rikuperimit të plotë të kostove;
- 1.5 Në rastin e projekteve që adresojnë klientët e cenueshëm nga ana sociale dhe shëndetësore (pjesa më e madhe e grupeve të cenueshme), për të përmirësuar kushtet minimale të jetesës dhe sigurinë e jetesës;
- 1.6 Si mbështetje shtesë për institucionet publike, për të përkrahur asistencën teknike që nevojitet për të përgatitur dhe zbatuar projektet e investimit me prioritet të lartë kombëtar në Planet Kombëtare të Veprimit për Efijencën e Energjisë (NEEAP) dhe Planet Komunale të Veprimit për Efijencën e Energjisë MEEAP).
- 1.7 Në rast të një nevoje të justifikuar për të rritur konkurrueshmërinë e masave të caktuara të efijencës së energjisë si pjesë integrale e projekteve të efijencës së energjisë në kushtet specifike lokale në Kosovë siç është rasti kur perioda e rikthimit të mbështetjes financiare pa një mbështetje të tillë mund të kalojë 15 vite.

2. Kriteret për marrjen e granteve duhet të jenë të qarta, të matshme dhe të caktuara në bazë të të dhënave dhe informatave publike. Për çdo skemë grantesh duhet të merret miratimi i Bordit të Drejtorëve.

3. Metodologjia (opsionet dhe kufizimet) për dhënien e granteve definohe në mënyrë të qartë në thirrje publike (parimi kush vjen i pari shërbehët i pari) ose përmes tenderit publik në rast se projektet e efijencës së energjisë jepen në baza konkurruese.

VII. KUFIZIMET NË DHËNIEN E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR SHKAK TË RREGULLAVE PËR NDIHMËN SHTETËRORE

Neni 29 – Mbështetja financiare si ndihma shtetërore ose ndihma sipas rregullit “de minimis”

1. FKEE-ja mund të jap mbështetje financiare subjekteve të kualifikuara, të cilët përmenden në nën paragrafët 1.3 deri në 1.6 të paragrafit 1 të nenit 5 të Rregullores, në pajtim me rregullat në fuqi për dhënien e ndihmës shtetërore me këto kushte të përgjithshme operimi dhe Rregullat e FKEE-së për dhënien e ndihmës shtetërore dhe rregullin “de minimis” domethënë si:

1.1 MSHE,

1.2 Fondet e pakthyeshme(grante),

1.3 Çdo instrument tjetër financiar, i zhvilluar nga FKEE dhe i miratuar nga Bordi i Drejtorëve.

2. Kriteret, kushtet e dhënies, shumat e mbështetjes financiare dhe palët e kualifikuara përcaktohen në rregullat sipas paragrafit të mësipërm të këtij neni.

3. Gjatë përgatitjes së rregullave nga paragrafi 1 më sipër, si bazë për përgatitjen e thirrjes publike dhe çdo procedure tjetër për dhënie të mbështetjes financiare, FKEE-ja merr parasysh rregullat, kufizimet dhe fushëveprimet e ndihmave shtetërore të lejuara ose ndihmës sipas rregullit “de minimis”, i cili përcaktohet në legjislacionin në fuqi.

4. FKEE-ja merr parasysh rregullin e akumulimit të ndihmave shtetërore, çka do të thotë se shuma totale e ndihmave shtetërore që janë pranuar tashmë ose e ndihmës sipas rregullit “de minimis” për një përfitues, duke përfshirë asetet e dhëna të FKEE-së, nuk mund të tejkalojë shumën totale të lejuar të ndihmës për të njëjtat kosto të pranueshme të investimit.

VIII. QËLLIMI I SYNUAR I MBËSHTETJES FINANCIARE

Neni 30 - Caktimi i fondeve për mbështetje financiare

Mbështetja financiare duhet të përdoret në pajtim me qëllimin për të cilin është dhënë.

Neni 31 - Monitorimi i zbatimit të marrëveshjeve

1. FKEE-ja monitoron kryerjen e investimeve të përfituesit e saj në bazë të marrëveshjeve të vlefshme të lidhura.

2. Pavarësisht dispozitave të marrëveshjes individuale, FKEE-ja mund të vlerësoj, në çdo kohë, zbatimin e marrëveshjes nga perspektiva administrative-ligjore, teknike-teknologjike dhe financiare.

3. Me qëllim verifikimin e përdorimit të synuar të mbështetjes financiare, FKEE-ja kryen edhe inspektime për përdorimin investimet e financuara. FKEE-ja kryen të paktën një inspektim të secilit investim të një personi juridik ose ndërmarrës privat, për të cilën mbështetja financiare ishte miratuar.

4. Krahas dispozitave të zakonshme, marrëveshjet duhet të përfshijnë edhe dispozitat për modalitetin e verifikimit të realizimit të investimit, për mënyrën dhe afatet për informimin e FKEE-së dhe për sanksionet e aplikueshme për shkak të mos përmbushjes së dispozitave kontraktuale dhe shfrytëzimit të mbështetjes financiare për qëllimet e paparashikuara.

5. Në rastin e një MSHE-së, KFEJ-ja mund të përcaktojë masa ndryshme të monitorimit pas implementimit që ndryshojnë nga ato që paraqiten në paragrafët 1-4 të këtij neni, të cilat duhet të bëhen pjesë integrale e dokumenteve të projektit, të nxjerra nga FKEE-ja në faza të ndryshme të zhvillimit dhe zbatimit të projektit të investimit, duke përfshirë marrëveshjen për shërbime të energjisë.

Neni 32 - Informimi

1. Përfituesi duhet ta informojë FKEE-në, pa vonesa, lidhur me:

- 1.1 Të gjitha shmangiet e mundshme nga marrëveshja;
- 1.2 Çdo rrethanë që parandalon ose vonon zbatimin e marrëveshjes, të përmendur në nënparagrafin 1.1 më lart, dhe për masat për eliminimin e shkaqeve;
- 1.3 Statusin dhe ndryshimet e tjera thelbësore organizative dhe në fuqinë punëtore të përfituesit;
- 1.4 Ndryshimin e përfaqësuesit ligjor;
- 1.5 Rastin e paaftësisë për të shlyer borxhin;
- 1.6 Nisjen e procedurës së falimentimit, shpërbërjes së detyrueshme ose likuidimit.

2. Në rastin e MSHE-së, FKEE-ja mund të përcaktojë kërkesa shtesë që informacioni t'i jepet FKEE-së prej marrësit të shërbimeve sipas MSHE-së.

Neni 33 - Raportimi për mbështetjen financiare

1. FKEE-ja raporton dhe verifikon përdorimin e synuar të mbështetjes financiare të dhënë duke u mbështetur në raporte dhe dokumentacionin e siguruar, të cilat duhet të ofrohen nga institucioni, kompania, personi tjetër juridik ose ndërmarrja private si përfitues i mbështetjes financiare, dhe duhet të përfshijë vlerat e parametrave adekuatë, të cilët nevojiten për monitorimin sasior të investimit individual për të cilin është mbështetja financiare ishte miratuar.

2. Parametrat e përmendur në paragrafin e mësipërm duhet të përcaktohen për projekt individual të efikasitetit të energjisë në marrëveshjen për dhënie të mbështetjes financiare në bazë të të dhënave për përmbushjen e kushteve dhe kritereve që dalin nga aplikacioni.

3. Në rastet kur parashikohet marrja e një lejeje operimi, përfituesi duhet të dorëzojë lejen e operimit brenda 15 ditësh pas marrjes së saj.

4. Në investime, për të cilat përfituesit detyrohen të kryejnë matjet e para ose matje të tjera të rregullta të konsumit të energjisë, emetimeve ose aktiviteteve të ngjashme, në bazë të rregulloreve ligjore, përfituesi duhet t'i dorëzojë FKEE-së raporte vjetore lidhur me këto matje, në pajtim me rregulloret e vlefshme, me të cilat ka të bëjë investimi.

5. Institucioni, kompania, personi tjetër juridik ose ndërmarrja private, në cilësinë e përfituesit, duhet t'i dorëzojë FKEE-së:

5.1 Një raport përfundimtar brenda jo më shumë se tridhjetë (30) ditësh nga mbyllja e investimit, dhe

5.2 Raporte vjetore për kursimet nga energjia (kostot) dhe efektet mjedisore për të paktën tre (3) vjet rresht pas përfundimit të investimit.

6. Raportet e përfituesit, të përmendur në paragrafin e mëparshëm, duhet të kenë një përshkrim të ndryshimeve lidhur me konsumin e energjisë, kostot e energjisë dhe barrën mjedisore, të shprehura në vlerat e parametrave të përshtatshëm, për të cilët kërkohen vlera, përpara investimit dhe pas kryerjes së tij, në varësi të qëllimit të investimit individual.

7. Me kërkesën e KFEE-së, përfituesi, i përmendur në paragrafin e pestë të këtij neni, duhet të dorëzojë një raport vjetor për operimin dhe të dhëna, të cilat nevojiten për kryerjen e mbikëqyrjes së mëvonshme të ndihmave shtetërore, në pajtim me dispozitat që rregullojnë mbikëqyrjen e ndihmave shtetërore.

8. Përfituesi detyrohet t'i paraqesë KFEE-së edhe dokumentacione të tjera që kërkohen, ndërkohë që KFEE-ja mund të kërkojë mendimin e ekspertit me shpenzimet e përfituesit.

9. Në rastin e MSHE-së, KFEE-ja mund të përcaktojë kërkesa të ndryshme për raportim për përfituesin.

Neni 34 - Përdorimi i synuar i mbështetjes financiare

1. Përdorimi i synuar i mbështetjes financiare të dhënë sigurohet me anë të dokumentimit të përdorimit të fondeve.

2. Përfituesi duhet të dokumentojë qëllimin e shfrytëzimit për secilin transferim të fondeve.

3. Asetet i transferohen drejtpërdrejt përfituesit ose kontraktorëve, furnizuesve ose ndonjë personi tjetër të tij që ka të drejtë të përfitojë, në bazë të dokumenteve të përshtatshme të dorëzuara (marrëveshjet, faturat e parapërgatitura, faturat, situatat e ndërtimit ose ndonjë dokument tjetër) ose, përndryshe, sipas përcaktimit të bërë nga marrëveshja ose thirrja publike ose ndonjë procedurë tjetër për dhënien e mbështetjes financiare të miratuar.

4. Në rastin e MSHE-së, KFEE-ja mbetet përgjegjës për ruajtjen e qëllimit të përdorimit të mbështetjes financiare të miratuar.

Neni 35 - Efektet e përmirësimit të efijencës së energjisë të investimeve të personave fizikë

1. Efektet e parashikuara të përmirësimit të efijencës së energjisë të një investimi të bashkëfinancuar, i realizuar nga një person fizik, konsiderohet i kryer me përfundimin me sukses të investimit.

2. Përfundimi i investimit duhet të konfirmohet me shkrim nga një person fizik si pranues i stimulit, së bashku me ofruesin e punimeve të investimit.

3. Inspektimet e rregullta në terren duhet të kryhen me anë të përzgjedhjes rastësore në të paktën 2% të marrëveshjeve MSHA dhe marrëveshjeve për grante me përfituesit, për të cilat mbështetja financiare dhe stimujt janë dhënë, me anë të një thirrjeje individuale publike.

IX. NDRYSHIMET E MARRËVESHJEVE PËR DHËNIEN E MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 36 - Ndryshimi i marrëveshjes për dhënie e mbështetje financiare

1. Me propozimin e përfituesit, drejtori menaxhues i FKEE-së vendos për lidhjen e marrëveshjes për ndryshimin e marrëveshjes së lidhur për dhënie e mbështetje financiare, me kusht që përfituesi të ketë përmbushur plotësisht më parë detyrimet kontraktuale. Gjatë këtij procesi, duhet të merren parasysh të gjitha kushtet e thirrjes publike ose cilësdo procedure tjetër, në bazë të të cilave është lidhur marrëveshja fillestare për dhënie e mbështetje financiare. Këto ndryshime të marrëveshjes janë përjashtuar në rastet e përmendura në nenin 38 të këtyre kushteve të përgjithshme të operimit.

2. Në rast të rinovimit, modifikimit ose ndryshimit të marrëveshjes për dhënie e mbështetje financiare në pajtim me paragrafin e mëparshëm, duket të mbahet parasysh rregulli që shuma e përgjithshme e ndihmave shtetërore të pranuar nga pranuesi i mbështetje financiare prej burimeve publike nuk duhet të tejkalojë shumën e lejuar të ndihmave shtetërore.

X. RRJEDHOJAT E MOSPËRMBUSHJES SË DETYRIMEVE

Neni 37 - Shkelja e marrëveshjes për dhënie e mbështetje financiare

1. FKEE-ja mund të tërhiqet njëanshmërisht nga marrëveshja dhe ta ndërpresë ose shtyjë për më vonë përdorimin e aseteve nëse:

- 1.1 Përfituesi nuk merr parasysh dispozitat e thirrjes publike, tenderit publik ose ndonjë procedure tjetër për dhënie e mbështetje financiare
- 1.2 Faktehen parregullsi të tjera në përdorimin e aseteve,
- 1.3 Nëse përfituesi nuk informon rregullisht dhe brenda afateve për të gjitha faktet e referuara në nenin 33 të këtyre kushteve të përgjithshme të operimit.
- 1.4 Faktehen devijime nga detyrimet e kontratës së miratuar,
- 1.5 Përfituesi ndalon operimin e rregullt ose humbet aftësinë e shlyerjes së borxhit, sipas mendimit të FKEE-së, ose nëse prona e tij zvogëlohet ndjeshëm sipas mendimit të FKEE-së, dhe kjo do të mund të ndikonte në përmbushjen e detyrimit kontraktual,
- 1.6 Ndaj pronës së tij, niset ndonjë procedurë për falimentim, likuidim dhe ekzekutim ose ndonjë procedurë tjetër, gjë që, sipas mendimit të FKEE-së, do të mund të ndikonte thelbësisht në aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje.

2. Në rastet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, devijimet e konstatuara më të vogla prej marrëveshjes, sipas mendimit të mëparshëm pozitiv të Bordit të Drejtorëve të FKEE-së, mund të eliminohen me rinovim të përshtatshëm të marrëveshjes së lidhur ose me anë të modifikimit të saj.

3. FKEE-ja e ndërpret menjëherë dhe njëanshmërisht marrëveshjen, ndërkohë që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga marrja e kërkesës së tij, përfituesi detyrohet t'i paguajë FKEE-së shumën e të gjitha aseteve që i janë paguar, në pajtim me marrëveshjen e lidhur, në një shumë të vetme, së bashku me interesat e vlefshëm si interesa të vonuara, domethënë prej ditës së transfertës e deri në ditën e kthimit të aseteve, nëse:

- 3.1 Përfituesi përdor mbështetjen financiare pjesërisht ose plotësisht pa qëllim;
 - 3.2 Të dhënat që jepen nga pranuesi në kërkesën për marrjen e mbështetjes financiare ose me lidhjen e marrëveshjes janë të pavërteta ose jo të plota.
4. Në rast të dyshimit të bazuar se përfituesi ka dhënë qëllimisht të dhëna të pasakta në aplikacion, FKEE-ja, mund të bëjë kallëzim penal ndaj përfituesit në prokurorinë kompetente të shtetit.

XI. ZBATIMI I PROCEDURAVE T PROCURIMIT PUBLIK

Neni 38 - Konteksti i Tenderit Publik

1. Tenderi publik do të jetë metoda kryesore e përdorur nga FKEE për marrjen e ofertave për Furnizim me Mallra, Shërbime dhe Punë dhe përzgjedhjen e konsulentëve në baza konkurruese sipas dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.
2. Përmbajtja e tenderit publik, përbërja e komisionit për vlerësimin e tenderëve, procedura e hapjes dhe vlerësimin aplikohen sipas Ligjit të Kosovës për Prokurimin Publik dhe çdo akti nënligjor të nxjerrë në zbatim të tij.
2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 edhe 2 të këtij neni, FKEE mund të zbatojë një procedurë të ndryshme të prokurimit publik nga ajo e paraparë me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, kur përzgjedh kontraktuesit për Furnizim të Mallrave dhe Shërbimeve ose kontraktuesit për punë nëse kjo procedurë përcaktohet si një procedurë mbizotëruese në marrëveshjen me një IFN ose donator, bazuar në një marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar në Republikën e Kosovës.

XII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 39 - Rregullat e KFEE-së për dhënien e ndihmave shtetërore dhe ndihmave “de minimis”

Drejtori menaxhues i KFEE-së miraton rregullat e KFEE-së për dhënien e ndihmave shtetërore ose ndihmës “de minimis” brenda tre (3) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtyre kushteve të përgjithshme të operimit. Këto rregulla duhet të jenë në përputhje me Ligjin për Ndihmën Shtetërore dhe legjislacionin Sekondar të kësaj fushe.

Neni 40 - Manuali i operacioneve i KFEE-së

Brenda tre (3) muajsh pas miratimit të kushteve të përgjithshme të operimit, Bordi i Drejtoreve nxjerr dhe miraton “Manualin e operacioneve” të KFEE-së.

Neni 41 - Hyrja në fuqi

1. Këto kushte të përgjithshme të operimit hyjnë në fuqi me miratimin e Bordit të Drejtorëve të KFEE-së.
2. Këto kushte të përgjithshme operimi mund të ndërpriten ose plotësohen në të njëjtën mënyrë që është miratuar kjo Rregullore.
3. KFEE-ja publikon kushtet e përgjithshme të operimit në faqen zyrtare të internetit.

Datë: 22. 08. 2019.

Lum Mita

Kryesues i Bordit të Drejtorëve, Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë